



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.123/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shtyll elektrike të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,800.00 (njëmij e tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 04.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 03.10.2017 në fshatin Sojevë të komunës së Ferizajt kanë hasur posterin e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal të Ferizajt nga subjekti politik LDK të vendosur në një shtyll elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014, si dhe nenit 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2017, subjekti politik LDK, e mohon se ka vendosur postera në shtyll elektrike pasi që po ti kishin vendosur ata do ti vendosnin në më shumë se një shtyllë elektrike e për të cilën edhe parashtruesi i ankesës do të sillte si dëshmi më shumë foto për shkeljen e supozuar. Mirpo pavarësisht kësaj subjekti politik LDK ka kërkuar nga dega e saj në Ferizaj që ta largon posterin nga vendi ku ka qene i vendosur.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterin nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajt nga LDK-ja është vendosur në shtyll elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri reklamues i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajt nga ky subjekt politik, është vendosur në objekt publik,

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posteri reklamues i kandidatit nga subjekti politik LDK është vendosur në shtyll elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.123/2017 më datën 06.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.